



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr .538. Akti

Nr. 436 Vendimi
Tiranë, më 09.09.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z.Gerrit Sprenger, asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, mori në shqyrtim çështjen:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Piro Sota**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Ndërprerja e procesit të rivlerësimit kalimtar.**

BAZA LIGJORE: **Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Germa “a” e pikës 1, të nenit 64 dhe neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese;

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, analizoi vendimin nr.***, datë 22.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për miratimin e heqjes dorë nga statusi i magjistratit nga subjekti i rivlerësimit, z.Piro Sota, dhe e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z.Piro Sota, subjekt rivlerësimi, për shkak të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të

rivlerësimit, duke u shortuar në datë 15.06.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Olsi Komici dhe Xhensila Pine.

2. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Trupi gjykues, pas njohjes me raportet e sipërcituara, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Komisioni, me anë të postës elektronike, në vijim njoftoi subjektin e rivlerësimit se ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Komisioni në datë 28.07.2021 u njoftua nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi dorëheqjen që subjekti z.Piro Sota kishte paraqitur pranë këtij Këshilli dhe vendimarrjen e këtij të fundit.

6. Me vendimin nr.***, datë 22.07.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: (i) deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z.Piro Sota, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për shkak të dorëheqjes nga ky status; (ii) efektet e këtij urdhërimi fillojnë në datën 31.08.2021; (iii) një kopje e këtij vendimi i njoftohet z.Piro Sota, sipas kërkesave të germës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit të subjekteve; (iv) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Komisioni, me anë të postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të shprehej nëse donte të dëgjohej në seancë dëgjimore, sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” apo të paraqiste qëndrimin e saj me anë të postës elektronike, të shprehte vullnetin lidhur me dorëheqjen e dhënë pranë KLGJ-së, dhe të konfirmonte nëse ky vendim ishte ankimuar prej tij.

Subjekti i rivlerësimit, në datë 7.9.2021 njoftoi Komisionin, si vijon:

“ Përsa i perket vendimit të KLGJ-së dt.22.07.2021 i cili ka pranuar kërkesën time për dorëheqje dhe njëkohesisht ka deklaruar mbarimin e statusit tim si magjistrat, ju sqaroj se kam qenë dakort me këtë vendim dhe nuk e kam ankimuar atë.-Lidhur me procesin tim të rivlerësimit ju sqaroj se nuk dëshiroj të paraqitem në seancë dëgjimore pranë KPK-së, duke deklaruar njëkohesisht edhe njëherë para jush vullnetin tim të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e dhënë pranë KLGJ-së”.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

8. Kolegji i Posaçëm Apelit, në lidhje me praktikën e gjyqimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën të ndryshme të tij, po kështu dhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

9. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet, që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare¹.

b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

10. KLGJ-ja, bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 22.07.2021 ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z.Piro Sota gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në bazë të konfirmimit të subjektit me *e-mail*-in e datës 7.9.2021 ai nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit, të KLGJ-së.

11. Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin se dorëheqja gjatë procesit të rivlerësimit bazohet në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye i kërkoi subjektit të shprehte në mënyrë të qartë dhe të pavesuar vullnetin e saj mbi dorëheqjen nga statusi i magjistratit në seancë dëgjimore ose me anë të postës elektronike.

12. Subjekti i rivlerësimit, z.Piro Sota, me anë të postës elektronike konfirmoi vullnetin e tij të lirë dhe të pavesuar në lidhje me dorëheqjen e parashtruar dhe të miratuar nga KLGJ-ja dhe parashtrroi se nuk dëshironte të dëgjohej në seancë dëgjimore.

13. Bazuar në konfirmimin e vullnetit të lirë dhe të pavesuar për dorëheqjen nga statusi i magjistratit dhe deklarin e subjektit se nuk dëshironte të dëgjohej në seancë dëgjimore, në referim të germës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, procedura administrative u vlerësua të mbyllet pa zhvillimin e seancës dëgjimore.

c. Baza ligjore për ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit

14. Në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

15. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”parashikon procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes: *“Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para këshillit përkatës.Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin e me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”*.

16. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.*

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

17. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ndër të tjera, ka interpretuar lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në*

¹ Vendimi nr.1/2018 (JR), datë 11.6.2018, i KPA-së, paragrafëve 96 dhe 97.

detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

PËR KËTO ARSYE,

18. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 89/b të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z.Piro Sota me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Ndalimin e emërimit të z.Piro Sota si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 9.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli
Kryesuese

Xhensila Pine
Relatore

Olsi Komici
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku